

Akt Themelimi

I shoqërisë tregtare “ALBA RECYKLING GOLEM” Shpk

Mbeshtetur në Kushtetutën dhe Kodin Civil në Fuqi të Republikës së Shqipërisë, në ligjin Nr.7512 datë 10.08.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, në mënyrë të lirë dhe të veprimitarise private dhe privatizimit”, të ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008, “Për shoqëritë tregtare” dhe të ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007 “Për Q.K.R dhe formalitetet që duhen respektuar nga Shoqëritë Tregtare, me vullnetin e tyre të lirë, të shprehur edhe në nënshkrimin e këtij akt-themelimi, themeluesit z. Agron Murrizi lindur me 09.11.1996 në Kavajë dhe i identifikuar me dokument me Kartë Identiteti nr. J61109042R dhe Z. Fidan Latifaj lindur me 17.12.1986 në Pejë, Kosovë me dokument identifikimi me nr.ID0541417.

Formulimi

Neni 1

Sot me datë 05.02.2021, formohet shoqëria tregtare private e quajtur “ALBA RECYKLING GOLEM” SH.P.K. Shoqëria do të nënshtrohet legjislacionit Shqiptar, ndërsa deget që mund të krijohen do të nënshtrohen legjislacionit ku do të ketë selinë degë. Shoqëria do të ushtroje veprimtarinë e saj në bazë të këtij akti themelues dhe statutit të shoqërisë që do të miratohet nga ortakët themelues.

Selia e Shoqërisë

Neni 2

Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Në Kavajë, Lagja nr.2, Bulevardi Josif Budo, e ndodhur në zonën kadastrale nr.8551, pasuria me numer 4/367+3-N15

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra perfaqësie, dege, të krijojë filiale si brenda ashtu dhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të asamblesë dhe ortakëve të saj.

Objektivi i Veprimitarise

Neni 3

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

Rikuperim i materialeve të klasifikuara, grumbullimi i mbeturinave jo të rrezikshme, trajtimi dhe asgjësimi i mbeturinave, cmontimi i mbeturinave metalike, përpunimi i mbeturinave të ndryshme dhe tregtimi i tyre në pikat e specializuara. Import, eksporti i mbetjeve teknologjike dhe mbeturinave të letres dhe të tjera të përaferta.

Projektme inxhinierike, prodhimin, instalimin dhe mirëmbajtjen e makinerive dhe pajisjeve industriale; import dhe eksport të makinave të prodhuara dhe pajisjeve të pjesëve të këmbimit: blerjen e të gjitha llojeve të mallrave, me qëllim për të shitur ato në formën e tyre origjinale ose të transformuara, importin dhe eksportin e tyre, si dhe riekportin e tyre pas përfundimit të procesit të prodhimit. Aktivitet në fushën e turizmit, shëndetësisë, hotelieri-restorante, agjensi shërbimesh për të gjitha llojet, perfaqësi tregtare, prodhimin dhe tregtimin e çdo lloji produkti bujqësor e blegtoral, agjensi mobilare dhe imobilare, si dhe çdo lloji aktiviteti prodhues dhe tregtar që lejohet nga ligji.

Kohezgjatja e Shoqërisë

Neni 4

Kohezgjatja e shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar. Ajo mund të shpërbehet në çdo kohë dhe për çfarëdo lloji shkak.

Kapitali i Shoqerise

Neni 5

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100.000 (njëqind mijë) Leke.

1. 1 Ortaku themelues z. Agron Murrizi: Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 50.000 (pesedhete mije) leke, që përben 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
2. Ortaku themelues Z. Fidan Latifaj: Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 50.000 (pesedhete mije) leke, që përben 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Drejtimi i Shoqerise

Neni 6

Shoqeria do te drejtohet nga administratori i saj z.Agron Murrizi i cili do te jete dhe perfaqesuesi ligjor i saj. Ai eshte perfaqesuesi i Shoqerise ne marredhenie me te tretet dhe ka kompetenca te plota ne drejtimin e saj.

Cdo kontrate do te kryhet prej tij dhe ne rast mungese nga nje perfaqesues i pajisur me prokure te posaçme.

Neni 7

Te ardhurat neto te shoqerise i takojne ortakut.

Neni 8

Ortaku ka te drejte te emeroje dhe administratore te tjere te vlerave materiale.

Ka te drejte te caktojte financiere, likuidator per problemet e shoqerise si dhe te pajtojte persona te tjere si ortake.

Neni 9

Konfliktet qe mund te lindin do te zgjidhen ne zbatim te legjislacionit Shqiptar ne Gjykatën e Rethit Gjyqesor Kavaje.

Neni 10

Shoqeria ka vulen e saj me madhesi te zakonshme, me tekstin rreth saj.

Neni 11

Shoqeria deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave te statutit dhe ne perputhje me legjislacionin Shqiptar ne fuqi dhe vecanerisht te Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Per Krijimin e Shoqerive Tregtare", si dhe duke zbatuar ligjet nderkombetare dhe te vendit si dhe rregullave qe zbatohen per biznesin qe kryen kjo shoqeri .

Neni 12

Akti i themelimit u perpilua ne 2 kopje, per t'ju shperndare organeve kompetente dhe nje kopje do te mbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise "ALBA RECYKLING GOLEM" SH.P.K.

Akti i themelimit nenshkruhet rregullisht nga ortakët.

Ortakët themelues:

Agron Murrizi

Fidan Latifaj